

Übersetzung aus der deutschen Sprache

**Logo / Adresa
e autoriteteve / organizatave
kompetente për lidhjen e marrëveshjes**

MARRËVESHJE E INTEGRIMIT¹

ndërmjet

të dhënat personale të emigrantit/emigrantes përkatës/e
(në vazhdim: nënshkruesi/nënshkruesja)

dhe

**autoritetit / organizatës kompetent/e për lidhjen e Marrëveshjes së Integrimit
emri**

Kjo Marrëveshje e Integrimit duhet të kontribuojë që të nxitet integrimi në rrafshin individual dhe orientohet me atë rast në parimet e juridiksionit për të huajt të federatës, sipas së cilës

- qëllim i politikës zvicerane të integrimit është që të nxisë bashkëjetesën paqësore të gjithëve mbi themelin e vlerave të Kushtetutës Federale dhe të respektimit dhe tolerancës reciproke;
- një integrim i suksesshëm është rezultat i një procesi reciprok, i cili si parakusht ka si gatishmërinë e të huajave dhe të huajve për integrim ashtu edhe hapjen e popullsisë zvicerane;
- Federata, kantonet dhe komunat synojnë barazi të shanseve dhe pjesëmarrje të të huajave dhe të huajve, të cilët qëndrojnë ligjshëm dhe përgjithmonë në Zvicër. Ata duhet të marrin qasje me shanse të njëjta në jetën ekonomike, shoqërore dhe sociale dhe të mund të marrin pjesë në të;
- nga të ardhurit pritet që të merren me rrethanat dhe kushtet e jetës në Zvicër dhe t'u përmbahen rregullave dhe ligjeve të vlefshme. E pashmangshme është që personat me një perspektivë afatgjate të qëndrimit t'i përvetësojnë njohurit e gjuhës vendëse që flitet në vendbanimin e tyre.

¹ Neni 54 i Ligjit Federal për të Huajat dhe të Huajt, dt. 16 dhjetor 2005 (AuG), SR 142.20, dhe neni 5 i Rregullores për Integrimin e të Huajave dhe të Huajve (VIntA), dt. 24 tetor 2007, SR 142.208 dhe eventalisht ligjet kantonale.

I. Të dhënat rreth personit

Shënimet personale:

Mbiemri:
 Emri:
 Rruga:
 Kodi postar, vendi:
 Tel. P:
 Tel. Z:
 Mobili:
 E-mail:

Shtetësia:
 Gjendja civile:
 Data e lindjes:
 ZAR-Nr.:

Ardhja në Zvicër më:
 Ardhja në kantonin XY më:

Qëllimi i qëndrimit:

Njohurit e gjuhëve:

Gjuha/gjuhët amtare:
 Gjuhët e tjera:
 Njohja e gjuhës gjermane (GER)²:

Veprimtaria e tanishme:

Punësimi:
 Përqindja e punës:
 Punëdhënësi:

Puna edukative:
 Numri i fëmijëve që edukohen:
 Moshë e fëmijëve:

II. Qëllimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka për qëllim përmbushjen e kushtit të caktuar në Urdhrin dt. të Zyrës kantonale të Migracionit "Vijimi i një kursi të gjuhës" ose: "Vijimi i një kursi të integritit".

Nënshkruesi/hënshkruesja, (emri i personit përkatës)

A. Gjuha

- mund të merret vesh në jetën e përditshme në gjuhën gjermane.
 merr pjesë në një kurs të gjuhës me këto qëllime:

² Korniza e Përbashkët Evropiane Referuese për Gjuhët e Këshillit të Evropës

B. Kushtet e jetës në Zvicër

- i njeh funksionet e institucioneve zvicerane (shkolla, arsimi profesional, puna, shëndetësia etj.).
- i njeh raportet shoqërore, sistemin ligjor dhe vlerat dhe normat themelore sipas Kushtetutës Federale zvicerane, veçanërisht rëndësinë e pozitës së barabartë të gruas dhe burrit.
-

III. Përkrahja nga Kantoni

Kantoni e informon nënshkruesen / nënshkruenin për ofertat e ndryshme të kurseve të gjuhës dhe të integritit si dhe për këshillimoret ekzistuese.

IV. Detyrimi i nënshkruetit / nënshkrueses**1. Masat:****A. Kurset e gjuhës:**

Kurset e përgjithshme të gjuhës:

- Mësimi i alfabetit
- Kursi bazë
- Kursi i konverzacionit

Afati kohor:

- _____ muaj
- _____ muaj
- _____ muaj

B. Kurset e integritit:

Kursi i integritit

Afati kohor:

- _____ muaj

2. Dëshmia për vijimin e kursit dhe e certifikatës

Zyra e përmendur nga kantoni (institucioni, qendra e kursit) vërteton pjesëmarrjen si dhe arritjen e qëllimeve të synuara me pjesëmarrjen në kurs, të cilat u përcaktuan në raste të veçanta.

Deri më(data)(emri i nënshkruetit/nënshkrueses) ia dërgon autoritetit kompetent **pa ia kërkuar** një kopje të vërtetimit për vijimin e kursit ose kopje të certifikatës në këtë adresë:

V. Pasojat e përbushjes apo mospërbushjes së kushtit të caktuar nga Zyra kantonale e Migracionit “Vijimi i një kursi të gjuhës ose të integrimit”

Në urdhrin dt. të autoritetit kantonal të migracionit, përkitazi me dhënien / vazhdimin e lejes së qëndrimit, nënshkruesi / nënshkruesja u detyrua të marrë pjesë në një kurs të integrimit / kurs të gjuhës dhe t'i arrijë qëllimet e synuara me pjesëmarrjen në kurs.

Mospërbushja e këtij kushti shikohet si mungesë e gatishmërisë për integrim dhe në kuadër të vendimit sipas vlerësimit, të cilën e merr autoriteti kantonal i migracionit në lidhje me çështjen e vazhdimin të lejes së qëndrimit, mund të çojë deri atje që leja e qëndrimit të mos vazhdohet.

Nëse nënshkruesi/nënshkruesja vijon kursin e paraparë dhe ia përcjellë vërtetimin përkatës autoritetit kompetent (adresa në fund të pikës IV), kjo mund të ndikojë pozitivisht në vendimin për leje. Për shembull, në kuadër të vazhdimin të lejes së qëndrimit apo gjatë mundësisë që leja e përhershme e qëndrimit të merret para kohe.

Nënshkrimi i emigrantit /
emigrantes:

Nënshkrimi dhe vula e autoritetit
apo institucionit kompetent kantonal

.....
Vendi, data

.....
Vendi, data

Te bashkëshortët dhe partneritetet e regjistruara përbajtjen e Marrëveshjes e merr në dijeni bashkëshorti/bashkëshortja përkatësisht partneri/partnerja; tek të miturit e merr / marrin përfaqësuesi/t ligjor/ë dhe e vërtetojnë këtë me nënshkrim:

.....
Vendi, data

.....
Vendi, data

Anekset, p.sh.:

Lista e kurseve të gjuhës dhe të integrimit në kanton / qytet

Shkresa të tjera informuese

Shkalla globale GER

Lista e kritereve për dhënien e parakohshme të lejes së përhershme të qëndrimit

Kopja:

Nënshkruesi/nënshkruesja

ev.: Zyra kontaktuese kantonale për çështje të integrimit

ev.: Autoriteti kantonal i migracionit (Zyra për të Huaj)

.....